

Aulona Jani ka lindur më 22 Nëntor 1981, në qytetin e Vlorës.

Zj. Jani ka kryer studimet e larta në periudhën 2000-2004, për Financë-Kontabilitet, në Universitetin e Tiranës. Fakulteti i Ekonomisë. Ndërsa gjatë periudhës 2011-2013, ka përfunduar programet e studimit “Master në Administrim Biznesi” po në këtë Fakultet.

Ajo gëzon një eksperiencë administrative mbi 7 vjecare në fushën e auditimit të jashtëm publik, si dhe një eksperiencë të mëparshme 10 vjeçare në sistemin bankar, ku ka qenë e angazhuar në pozicione të ndryshme në fushën e kredithënies së korporatave.

Në vitin 2015, Zj. Jani ka ndjekur për një periudhë 5 mujore, programin e “Internship”-it në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Njesisë së Besueshmërisë së Pasqyrave Financiare (CEAD), përgjegjësia e të cilës konsiston në përgatitjen dhe hartimin Deklaratën e Sigurisë mbi besueshmërinë e Pasqyrave Financiare të Komisionit Evropian.

Gjithashtu, në vitin 2017, për një periudhë 4 mujore, Zj. Jani ka qenë pjesë programit të trajnimit “International Auditor Felloëship Program”, në GAO – “Zyra e Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA-ve”, në Ëashington DC, ku ka ndjekur 640 orë trajnimi të përbërë nga kurse, seminare dhe e-learning, si dhe ka përgatitur punimin strategjik “Nje qasje drejt përmirësimit të kontrolleve të brendshme në sektorin publik në Shqipëri mbështetur në eksperiencën e GAO-s”.

Gjatë karrierës së saj profesionale ka marrë pjesë në trajnime, kongrese, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me çështje të auditimit të jashtëm publik dhe institucioneve supreme të auditimit.

Prej vitit 2014, ajo ka ushtruar pozicionin e audituesit, e më pas kryeaudituesit në departamente auditimi dhe aktualisht pranë Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, mban pozicionin Drejtorit të këtij departamenti.

Zj. Jani është njohëse shumë e mirë e gjuhës angleze dhe italiane.